

## Akt Thmelimi

I shoqërisë tregtare “ACCESS RENTAL” sh.p.k

Sot më datë 11.12.2024, ne të nënshkruarit:

1. Andi Goga
2. Alketa Doci

me vullnetin tonë të lirë dhe të plotë në mbështetje të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” hartoj këtë Akt Themeli të Shoqërisë “ACCESS RENTAL” sh.p.k, si më poshtë vijon:

### **1. FORMA LIGJORE**

“ACCESS RENTAL” sh.p.k është një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar.

### **2. ORTAKËT THEMELUES**

Ortakët themelues të shoqërisë tregtare janë :

- a. Andi Goga
- b. Alketa Doci

### **3. OBJEKTI**

Shoqëria do të krijohet me qëllim:

- Dheni automjete me qira, shitje , blerje automjete me pakice .

### **4. SELIA E SHOQËRISË**

Selia e shoqërisë tregtare “Access Rental” SHPK do të jetë në adresën: Durrës Krujë Qereke, ,Toke are, zona kadastrale nr. 3096, me numër pasurie 235/6

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj , të hapë zyra përfaqësie , degë , të krijojë filiale në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë , vetëm me vendim të asamblesë dhe ortakëve të saj .

Shoqëria ka vulen e saj me madhesi te zakonshme, me tekstin rrith saj .

### **5. KOHËZGJATJA**

Shoqëria krijohet për të vepruar për gjithë kohën e përcaktuar për sa kohë do ketë treg në shitjen e automjeteve dhe dhenjen e tyre me qira.

### **6. KAPITALI I SHOQËRISË**

Kapitali themeltar i shoqërisë tregtare “Access Rental “ sh.p.k është 100.000 (*njëqindmijë*) lekë

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë tregtare mund të shtohet ose të pakësohet ( por jo nën vlerën e kapitalit themeltar fillestar )

### **7. ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME ORTAKËVE DHE PËRFAQËSUESI LIGJOR**

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të shoqërisë tregtare "Access Rental" sh.p.k është edhe organi më i lartë i saj.

Përfaqësuesit ligjorë të shoqërisë do të janë \_ Andi Goga, dhe Alketa Doci.

## 8. DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

8.1 Shoqëria do të administrohet nga 1 (një) administrator i vetëm i emëruar dhe i pandryshueshmë në përputhje me këtë statut për të gjithë kohëzgjatjen e shoqërise.

8.2 Administratori i Shoqërisë mund të shkarkohet nga pozicioni që ka në Shoqëri në çdo kohë nga Asambleja e Ortakëve me Shumicë të Zakonshme. Në asnjë rast ortakëve nuk i duhet të justifikojnë apo provojnë se cilat janë shkaqet për të cilat ata shkarkojnë administratorin. Në çdo rast janë ortakët ata të cilët vlerësojnë se ka shkaqe të arsyeshme për shkarkimin e administratorit

8.3 Administratori ka të drejtë të përfaqësojë Shoqërinë në mënyrë të plotë për administrimin e zakonshëm të saj si edhe të drejtën për të miratuar të gjitha vendimet që i gjykon të përshtatshme për arritur dhe përbushur qëllimin e shoqërisë, me përashtim të vendimeve që me ligj i takojnë Asamblesë së Ortakëve.

Administratori mund të autorizoje palë të treta për ta përfaqësuar atë në transaksione të veçanta me anë të një prokure të hartuar para noterit.

8.4 Personi i mëposhtëm do të caktohet si Administrator i Shoqërisë për një afat 3 vjeçar për të gjithë periudhën e kohëzgjatjes së shoqërise:

Z. Andi Goga, shtetas shqiptar, i biri i Vilson, i datëlindjes 17.06.1991, lindur ne Fier dhe banues në Tirane, mbajtës Leternjoftimit me numër 035299703 dhe numër personal J10617104N, lëshuar nga Ministria e Brendshme datë 11.12.2019.

## 9. PRISHJA DHE LIKUJDIMI I SHOQËRISË

Prishja dhe likujdimi i shoqërisë tregtare mund të bëhet në çdo kohë dhe për çfarëdo shkaku ligjor, duke përfshirë dhe falimentimin, pavlefshmëria e themelimit të shoqërisë të parashikuar nga ligji, për çdo shkak tjetër të vendosur me vullnetin e ortakëve të shoqërisë.

## 10. TË NDRYSHME

Akti i themelimit të shoqërisë u përpilua në 2(dy) ekzemplarë, njëra për tu dorëzuar pranë organeve kompetente dhe tjetra do të mbetet në dosjen e dokumentacionit të krijimit të shoqërisë "Access Rental" sh.p.k

Akti i themelimit të shoqërisë nënshkruhet rregullisht nga ortakët themelues .

**ORTAKËT THEMELUES**

**E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**"ACCESS RENTAL" Sh.p.k**

*Andi Goga* *Alketa Doci*